



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.476/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi, anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Fuad Hashani kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal të Obiliqit, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, paraqitur kundër Këshillit të Vendvotimit (KVV), për shkak të parregullsive në Vendvotim, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa ZL.Anr.476/2017 e datës 23.10.2017 e Fuad Hashani, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Obiliq.

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 23.10.2017 nga Fuad Hashani kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal Obiliq, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Obiliq, me të cilën pretendon se në këto qendra vendvotime (QV), ka pasur manipulime me vota si: në QV Shkolla Fillore “Hasan Prishtina” VV 1502/2R,1502/3D, Shkolla Fillore “Naim Frasheri” VV1503/01R,1503/22D, Shkolla Fillore “Migjeni” VV 1521/1D, 1505/1R, 1505/2D, Shkolla Fillore në fshatin Babimovc VV1507/01D, Shkolla Fillore “Fazli Grajçevci” VV 1508/1D, Shkolla Fillore ”Ibrahim Rugova” VV 1520/1R, 1520/2D, 1510/1R, dhe 1510/2D ku dyshohet se komisionarët nuk i kanë bartur numërin e votave në Formularin e Rezultateve Përfundimtare.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesën përkitazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesë, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi

shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ta hedh si të palejuar ankesën e ankuesit. Hedhja e ankesës të ankuesit nuk e paragjykon çështjen se ankuesit i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpallja së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Zl.Anr. 476/2017 me datën 24.10.2017.

Kryesuesi i Paneli
Zyhdi Haziri

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-